

## VEPRIMI KUNDËR KRIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI

### Cili është qëllimi?

Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri (AEC-AL) synon të kontribuojë në forcimin e luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, duke synuar të rrisë besimin në sundimin e ligjit dhe demokracinë në Shqipëri. Më konkretisht, Veprimi kundër Krimit Ekonomik do të mbështesë autoritetet në zbatimin efektiv të rekomandimeve kyçe dhe më të fundit të organeve monitoruese të Këshillit të Evropës, siç është Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) dhe Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) si dhe kontribuojnë në proceset reformuese në vend.

### Kush përfiton nga projekti?

Projekti do të bashkëpunojë ngushtë me përfitues të ndryshëm dhe homologë në organet qeverisëse në të gjitha nivelet, agjensitë e specializuara dhe organet mbikëqyrëse duke përfshirë:

- ▶ Parlamentin e Shqipërisë
- ▶ Ministrinë e Drejtësisë; Ministrinë e Brendshme; Ministrinë e Financave; Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kryeministrinë
- ▶ Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (HIDAACI)
- ▶ Shërbimet gjyqësore dhe të prokurorisë
- ▶ Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave
- ▶ Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare
- ▶ Bankën e Shqipërisë
- ▶ Qytetarët shqiptarë, organizatat e shoqërisë civile si dhe sektori privat

### Si do të funksionojë projekti?

Asistenca e ofruar përmes Projektit do të jepet nëpërmjet ndërhyrjeve këshilluese dhe forcimit të kapaciteteve, të përshtatura për nevojat specifike të përfituesve si dhe duke u bazuar në rezultatet e arritura në zbatimin e Fazës I të Instrumentit Horizontal(2016-2019). Më konkretisht, Projekti do të përqëndrohet në mbështetjen e autoriteteve në disa drejtime, duke përfshirë:

- ▶ forcimin e legjislacionit dhe kuadrit legjislativ;
- ▶ ndërtimin e kapaciteteve institucionale;
- ▶ rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

### Çfarë presim të arrijmë?

Projekti pritet të arrijë rezultate kyçe në mbështetjen e autoriteteve në disa drejtime, duke përfshirë:

- ▶ Përmirësimin e legjislacionit dhe kuadrit institucional për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- ▶ Forcimin e praktikave të rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve;
- ▶ Krijimin e mekanizmave efektivë për të parandaluar dhe frenuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- ▶ Nxitjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional në luftën kundër krimit ekonomik.

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

## Sa do te kushtojë?

- ▶ Buxheti i përgjithshëm i Projektit është 800.000 EUR;
- ▶ Buxheti i alokuar për programin e Instrumentit Horizontal arrin në 41 Million EUR (85% financuar nga Bashkimi Evropian dhe 15% financuar nga Këshilli i Evropës).

## Si mund të marrim më shumë informacion?

- ▶ Faqja e Internetit i Divizionit për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik: [www.coe.int/econcrime](http://www.coe.int/econcrime) dhe website i Veprimit kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri [www.coe.int/HF-II-AEC](http://www.coe.int/HF-II-AEC)
- ▶ Faqja e Internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Maia Mamulashvili, Koordinatore Programi, Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik, [Maia.Mamulashvili@coe.int](mailto:Maia.Mamulashvili@coe.int)
- ▶ Liljana Kaci, Oficere e Lartë Projekti, Divizioni për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik, [Liljana.Kaci@coe.int](mailto:Liljana.Kaci@coe.int)
- ▶ Marija Simić, Oficere Komunikimi për Instrumentin Horizontal, [Marija.SIMIC@coe.int](mailto:Marija.SIMIC@coe.int), +381 63 601 337
- ▶ Besnik Baka, Oficer Komunikimi për Instrumentin Horizontal, [Besnik.Baka@coe.int](mailto:Besnik.Baka@coe.int), +355 69 217 8430

## Rreth Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson përfituesve të përmbushin axhendat e tyre në kuadër të reformës në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe në përputhje me standardet evropiane, duke përfshirë aty ku është e nevojshme brenda kornizës së procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar përfshin Projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi, dhe në Kosovë \* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës nga maji 2019.

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe Opinioni e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinentit. Ai përfshin 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një konventë e krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

*Kjo broshurë u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë për të pasqyruar mendimin zyrtar të secilës palë.*

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



# HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY 2019-2022

*FOR YOUR RIGHTS: TOWARDS EUROPEAN STANDARDS*

---

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

---

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës